AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS

QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

# NEWSLETTER E DIASPORËS

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#32

## Nisin aplikimet për rregjistrimin e mësuesve në Diasporë




Një lajm i rëndësishëm për mësuesit në Diasporë. Fillojnë aplikimet për regjistrim në regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në Diasporë. Të gjithë mësuesit janë të ftuar të dorëzojnë aplikimet e tyre deri në datë 30 tetor. Ky regjistër do të përmbajë listën e mësuesve të cilët kanë të drejtë të japin mësim për programin e gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë. Gjithashtu aty do të pasqyrohen të dhënat e mësuesve në Diasporë të cilat do të bëhen pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e tyre, në ministrinë përgjegjëse.

## Ministri merr pjesë në konferencën "Sud e Futuri" në Palermo



Gjatë vizitës që zhvilloi në Itali, Ministri i Shteti për Diasporën z. Pandeli Majko mori pjesë në ceremoninë e hapjes së edicionit të parë të konferencës "Sud e Futuri" në Mondello (Palermo), Itali. Qëllimi i kësaj konference është identifikimi i strategjive dhe politikave që ndikojnë në zhvillimin e jetës socio-ekomonike të vendit. Ekspertë nga fusha e ekonomisë, politikës, kulturës, përfaqësues të universiteve dhe gazetarë nga disa vende të Mesdheut, do të marrin pjesë në këtë konferencë ku do të paraqesin propozimet e tyre për zhvillimin e jugut të Italisë.Pjesë e programit është zhvillimi i seminareve për të diskutuar rreth çështjeve me rëndësi siç janë:Qeverisja e Jugut; Mesdheut dhe skenarët globalë; Zhvillimi lokal dhe globalizimi; Legaliteti dhe demokracia; Ardhmëria, inovacioni dhe inteligjenca artificiale; Industria kulturore dhe skenarët e rinj në zhvillim.

## Miratohet vendimi për ndryshimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të FSHZHD-së




Këshilli i Ministrave miratoi ndryshimin e Vendimit 594, të datës 9.10.2018, "Për emërimin e Kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillim e Diasporës".Sipas këtij vendimi, znj. Dajna Sorensen, e cila do të jetë edhe Kryetare e Këshillit Drejtues të FSHZHD-së, zëvendëson z. Elton Haxhi, përfaqësues nga Ministria e Financave. Gjithashtu znj. Mira Hoxha emërohet si përfaqësuese nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme në vend të z. Andris Stastoli.Këshilli Drejtues i FSHZHD-së është një organ vendimmarrës për çështjet financiare, organizative dhe administrative të FSHZHD-së, në përmbushje të detyrave dhe funksioneve të tij.

## QBD merr pjesë në Kuvendin Ndërkombëtar të Albanologjisë në Kroaci



U zhvillua në Zara të Kroacisë, Kuvendi Ndërkombëtar i Albanologjisë "Symbiosis on the shores of the Adriatic Sea-Encounters and dialogues among cultures", organizuar nga revista "Shëjzat–Pleiades" në bashkëpunim me Universitetin e Zadarit, Shoqatën Italiane të Studimeve të Europës Juglindore dhe me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë. Në këtë kuvend marrin pjesë personalitete të rëndësishme të fushës së albanologjisë dhe ballkanologjisë si Francesco Altimari, Matteo Mandala, Andrey N.Sobolev, Lucia Nadin, Persida Asllani, Ardian Ndreca etj. Në hapjen e kuvendit përshëndetën Ambasadori shqiptar në Kroaci z. Riza Poda, prorektorja e Universitetit të Zadarit si dhe Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa, e cila përcolli përshëndetjet e Ministrit të Shtetit për Diasporën.

## KKD Britani / Ceremonia e çmimeve "Ambasador i Kombit" në ambasadë



Anëtarja e Këshillit Koordinues të Diasporës, znj. Brikena Muharremi, mori pjesë në ceremoninë e organizuar nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar për ndarjen e çmimeve "Ambasador i Kombit". Ky çmim I akorduar gjatë Samitit të Dytë të Diasporës iu dorëzua: z. Gëzim Alpion, znj. Lea Ypi, z. Dritan Dema, z. Olsi Qinami dhe znj. Ermelinda Beqiraj. Gjatë kësaj ceremonie u diskutua edhe për çështje që prekin Diasporën shqiptare dhe mundësitë për të ndihmuar komunitetin shqiptar.

## KKD Gjermani / Lazim Destani ndihmon shkollën për nxënës me nevoja të veçanta




Anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Lazim Destani rikthehet në vendlindjen e tij në Tetovë të Maqedonisë në përurimin e shkollës "Liria" për fëmijët me nevoja të veçanta. Ai dhe familja e tij janë bashkë-donatorë në mundësimin e këtij projekti që i vjen në ndihmë komunitetit. Në ceremoninë e përurimit, z. Destani shprehet se pati kënaqësinë të marrë pjesë në hapjen solemne të hapësirave të reja shkollore, ku do ta ndjekin procesin edukativo-arsimor fëmijët me nevoja të veçanta. Investimi në arsim e ka vlerën më të madhe se çdo investim tjetër, arsimi është çelësi i të ardhmes, - shprehet ai.

## Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"




App store këtu: Play store këtu:

## "Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme




Çdo qytetar shqiptar, brenda dhe jashtë vendit, tanimë ka mundësi të adresojë shqetësimin e tij drejtpërdrejt në të gjitha nivelet drejtuese të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, kjo falë rubrikës më të re "Raporto", e cila sapo është shtuar në platformën Ambasadalme.

- Për përdoruesit e iOS aplikacioni shkarkohet këtu:
- Për përdoruesit e Android aplikacioni shkarkohet këtu:

## Vizita në Itali, ministri takohet me kryetarin e Bashkisë së Palermos



Ministri i Shtetit për Diasporën u takua me kryetarin e Bashkisë së Palermos z.Leoluca Orlando. Gjatë takimit biseduan mbi marrëdhëniet e bashkëpunimet që ekzistojnë mes dy vendeve. "Marrëdhënia mes vendeve tona është tejet e veçantë, - tha ministri Majko, - pasi në Itali ne kemi dy Diaspora. Kemi Arbëreshët që prej shekujsh vazhdojnë të ruajnë gjuhën, kulturën dhe traditat e të parëve, por edhe Diasporën e re, atë të pas viteve '90".

## Programi i AKD në Ukrainë



Për herë të parë anëtarët e komunitetit shqiptar në Gamovka të Ukrainës po mësojnë vallet tradicionale shqiptare me valltarët profesionistë të Ansamblit Kombëtar Shqiptar. Këto mësime po realizohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit të Shqipërisë.

## Vallet shqiptare në komunitetin shqiptar në Divnyns'ke



Vazhdon programi i mësimit të valleve tradicionale në komunitetet shqiptare në Ukrainë. Këtë herë në komunitetin shqiptar në Divnyns'ke. Mësimi i valleve shqiptare në Ukrainë është një program që realizohet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit.

## Në ditën e pensionistëve në Tyushki, kërcehen vallet shqiptare



Gjatë mësimit të valleve dhe kulturës shqiptare edhe në fshatin Tyushki, Ukrainë. Valltarët profesionistë të Ansamblit Kombëtar Shqiptar morën pjesë në një aktivitet të organizuar për ditën e pensionistëve në këtë fshat, ku iu mësuan atyre vallet tradicionale shqiptare. Organizimi i këtyre klasave për anëtarët e komuniteti shqiptaro-ukrainas realizohet nga bashkëpunimi i Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Teatrit Kombëtarë të Operas dhe Baletit të Shqipërisë.

## QBD/ Shpërndahen tekstet falas në Greqi



Nxënësit shqiptarë në Hania të Greqisë, nisin vitin e ri shkollor me tekstet e dërguara falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Postën Shqiptare dhe nën kujdesin e Ministrit të Shtetit për Diasporën.

## QBD/ Shpërndahen tekstet falas në Itali



Nxënësit e shkollave shqipe në Merano, Bolzano,Trento,Bressanone, Mezzolombardo, Parma dhe Riva del Garda të Italisë, për herë të parë këtë vit do të mësojnë me abetaret dhe tekstet shkollore të shpërndara falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Postën Shqiptare dhe nën kujdesin e veçantë të Ministrit të Shtetit për Diasporën.

## QBD/ Shpërndahen tekstet falas në Angli



Nxënësit shqiptarë në Londër të Anglisë, kanë nisur vitin e ri shkollor me tekstet e dërguara falas nga Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Postën Shqiptare dhe nën kujdesin e Ministrit të Shtetit për Diasporën. Shkolla shqipe "Shoqata Ardhmëria" në mjediset e shkollës angleze "St.Augustine's CE Hight School" Kilburn, Londër të Anglisë bën një prezantim të ditës së parë me nxënësit.